



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:259870

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05859288

**C.nr.1309/19**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**, me gjyqtarin Driton Ahmeti dhe procesmbajtës Diellza Azemi – praktikante e kësaj gjykate, në çështjen juridike të iniciuar me padinë e paditësit G. R. dhe B.H. që të dy nga fshati K. Komuna Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Rafiz Shehu nga Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Rr.”Lidhja e Pejës”, Magj. Prishtinë-Fushë-Kosovë pn., në çështjen juridike kompensim i dëmit material dhe jo material, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 13.06.2024 në prezencë të të autorizuarit të paditësve dhe përfaqësuesit të palës së paditur mori publikisht, ndërsa me datë 25.06.2024 ka hartuar me shkrim këtë;

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësve G.R. dhe B.H. që të dy nga fshati K. Komuna Ferizaj, e ushtruar kundër të paditës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Rr.”Lidhja e Pejës”, Magj. Prishtinë-Fushë-Kosovë pn, me të cilën ka kërkuar që të ‘*Obligohet e paditura që paditësve pas përpilimit të ekspertizës paditësve t’ia paguaj shumat ..., me kamatë ligjore duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë*’ si e pa bazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

## A r s y e t i m i

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datë 08.11.2019 në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Rr.”Lidhja e Pejës”, Magj. Prishtinë-Fushë-Kosovë pn, për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Paditësit përmes të autorizuarit të tij gjatë shqyrtimit të çështjes dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse u administruan të gjitha provat kështu që ne mbesim ende në thëniet e seancës së kaluar dhe të sotmes duke shtuar se baza juridike e kërkesë padisë ekziston sidomos në aktgjykimin P.nr.1/18 i datës 02.09.2019 i bërë i plotëfushqishëm me 21.10.2019. Sipas marrëveshjes së palës së paditur me numër 641/19 i datës 03.06.2019 ku në nenin 2 është e cekur data që palët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre deri me datë 26.05.2019. Arsyeja pse nuk është bërë kërkesë padia me herët është shprehur epilogu i gjykimit dhe ligji e parasheh afatin e parashkrimit i cili rrjedhë nga data 21.10.2019 e që të kishin bërë kërkesë me herët ose padi ka qenë parakohshme andaj konsiderojmë se kërkesë padia është e afatshme dhe e ligjshme dhe pala e paditur ka obligim ligjor që paditësve të kompensojnë dëmin e shkaktuar. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës të OAK-së.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi si në deklaratimet si në seancat e kaluara parashtresës si dhe marrëveshjes me Likuidatorin të caktuar nga Banka Qendrore me BKS-së, kërkojmë nga gjykata që pasin dhe kërkesëpadinë e paditësve të refuzoj si të pa bazuar, pasi që nenin 6 i marrëveshjes është në tërësi i qartë, të gjitha dyshimet hiqen gjithashtu me neni 16 ku ceket që gjatë përpilimit të kësaj marrëveshjeje një kopje i është dorëzuar BQK-se me kërkesë për miratim nga organi mbikëqyrës për transferimin e portofolit të sigurimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimeve të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar këto prova: Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr 2016-CF-1303 i datës 24.06.2016 dhe foto albumi, shkresa e BKS-Së drejtuar avokatit të paditësve e datës 05.11.2019, raporti mjekësor me numër ...1 i datës 24.06.2016 i lëshuar në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj në emër të G.R., raporti mjekësor me numër ...8 i datës 24.06.2016 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj në emër të B.H., raporti mjekësor nga poliklinika “GJ.” i datës

06.07.2016 në emër të B.H., raporti nga konsulta në emër të B.H., parashtrësja e palës së paditur e datës 13.03.2024 me të cilën gjykatës i ka dorëzuar marrëveshjen për transferimin e portofolit të policave aktive të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penale me numër P.nr.1/18 i datës 02.09.2019.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është fakt i pa kontestuar se me datë 24.06.2016, ka ndodhur aksidenti në trafik, e kjo vërtetohet nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr.2016-CF-1303 i datës 24.06.2016 dhe foto albumi, nga i cili aksident paditësit kanë pësuar lëndime kjo vërtetohet nga raporti mjekësor me numër ... i datës 24.06.2016 i lëshuar në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj në emër të G.R., raporti mjekësor me numër 1048 i datës 24.06.2016 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj në emër të B.H., raporti mjekësor nga poliklinika “GJ.” i datës 06.07.2016 në emër të B.H., raporti nga konsulta në emër të B.H., i cili aksident ka ndodhur si pasojë e lëshimeve nga vetura e cila ishte me mbulesë siguruese nga ish Kompania e Sigurimeve “I.” e cila kompani e ka shpallur procedurën e falimentimit e cila procedurë është udhëhequr nga likuidatori i emruar z. N.L..

Nga leximin e marrëveshjes për transferimin e portofolit të policave aktive të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia e lidhur në mes likuidatorit të emruar z. N.L. për kompanin I. sh.a Dega në Kosovë dhe Siguruesit pranues – Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) përfaqësuar nga drejtori Ekzekutiv z. B.P., gjykata ka konstatuar se pasi që Kompania e Sigurimit I. ka shpallur falimentimin, sipas procedurave BQK ka caktuar likuidatorin i cili në bazë të ligjit është personi përgjegjës që mbikëqyrë procedurën e falimentimit dhe likuidimit, i cili ka lidhur marrëveshje për transferimin e portofolit të policave aktive të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia ku neni 6 i kësaj kontrate ka specifikuar në mënyrë të qartë se “siguruesi pranues nuk do të ketë asnjë detyrim lidhur me dëmet e shkaktuar deri me datën 26.06.2019”, ndërsa nga shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se aksidenti ka ndodhur me datë 24.06.2016, e që rrjedhimisht në rastin konkret të paditurës i mungon legjitimiteti real

pasive për të qenë pale në procedurë, por edhe detyrimi që paditësve të ia kompensoj dëmin e shkaktuar nga aksidenti i trafikut.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha këto pretendime të paditës, por ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar, për gjykatën nuk është kontestuese se paditësit në aksidentin e trafikut kanë pësuar lëndime nga i siguruari i ish Kompanisë së Sigurimeve “I.” sh.a me seli në Kosovë e cila ka filluar procedurën e falimentimit, ku si likuidatori i emëruar z. N.L. për kompanin I. sh.a Dega në Kosovë ka lidhur marrëveshje me siguruesin pranues – Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) për transferimin e portofolit të policave aktive të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, nga e cila marrëveshje e paditura (BKS) nuk do të ketë asnjë detyrim lidhur me dëmet e shkaktuar deri me datën 26.06.2019”, ndërsa aksidenti ka ndodhur brenda kësaj periudhe me datë 24.06.2016 andaj gjykata konsideron se nuk ekziston detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit që ju janë shkaktuar paditësve.

Në kontekst të të gjitha të lartcekurave gjykata ka analizuar dhe interpretuar dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së ku në thuhet se: *”Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”* dhe sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, është i nevojshëm të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktuesi i tij, dhe dëmi të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, me përjashtim të rasteve kur shkaktuesi i dëmit përgjigjet pavarësisht nga faji. Pra, detyrimi për shpërblimin e dëmit duhet të përmbajë prezumimet siç janë: dëmi i shkaktuar, veprimi i kundërligjshëm, lidhja shkakësore (kauzale) ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar.

Bazuar në të gjitha të lartcekurat, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësit nuk ka arritur të vërtetojë me asnjë provë se e paditura ka për detyrim kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e trafikut, me ç’ rast barra e provës i ka rënë të njëjtëve, andaj në këtë kontekst gjykata përkujton palët se sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, më tutje edhe me nenin 319 paragrafi 1, i të njëjtit ligj ka paraparë që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Pra përfundimisht gjykata ka vlerësuar se paditësit ka dështuar të vërtetoj lidhjen kauzale mes dëmit të shkaktuar dhe detyrimit për shpërblimin e këtij dëmi nga e paditura, andaj dhe si rezultat i kësaj ka refuzuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ashtu siç ka cekur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera materiale, dëshmitë e dëshmitarëve, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim për të vendosur ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës siç është cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 dhe 452 të LPK-së, ashtu që gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedural.

Nga të gjitha të lartcekura dhe konform dispozitave ligjore të sipër cituara dhe lidhur me nenin 142 dhe 143 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.1309/19, me datë 25.06.2024**

Gjyqtari,  
Driton Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.